



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT BERAT

Nr. 1148/13 Prot

Datë 31/12 / 2025

VENDIM

Nr. 10

Datë 29 / 12 / 2025

PËR

MIRATIMIN E BUXHETIT TË KËSHILLIT TË QARKUT BERAT PËR VITIN

2026 DHE PBA PËRFUNDIMTARE 2026-2028

Këshilli i Qarkut Berat pasi mori në shqyrtim materialin e paraqitur nga grupi i punës për hartimin e Projekt Buxhetit të Këshillit të Qarkut Berat për vitin 2026, mbështetur në kuadrin ligjor mbi procesin e buxhetimit vendor si më poshtë:

- Ligji nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 40
- Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”; neni 8, pika 2 ,neni 9 pika 1.1, b, neni 31 pika 1,2,3 neni 34, neni 38, neni 40, neni 41, neni 72 pika 5, neni 77 pika dh, neni 83, pika ç.
- Ligji nr. 9936/2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar;
- Ligji nr. 10296/2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”;
- Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 10/1 i vitit 2017 “Për përgatitjen e buxhetit vendor.”
- Ligji “Për Buxhetin e Vitit 2026”
- Ligje dhe akte nën ligjore të tjera,

VENDOSI:

Të miratojë të ardhurat dhe shpenzimet si më poshtë (në lekë):

I.TË ARDHURA GJITHSEJ	58,747,384
1. Të ardhurat e veta	
a) Grant i pakushtëzuar viti 2026	48,173,103
b) Transferta e pakushtëzuar sektoriale	7,074,281
c) Të ardhura nga Bashkitë	3,000,000
d) Të ardhura nga Shërbimet	500,000

II.SHPENZIME GJITHSEJ SIPAS BURIMIT TË FINANCIMIT

Tabela përmbledhëse e buxhetit të vitit 2026 sipas burimeve të financimit:

Nga granti i Pakushtëzuar 2026			
Lloji i shpenzimit	Llogaria	Shuma lekë	Në mijë lekë
Shpenzime për paga	600	24,830,504	24,831
Shpenzime për sigurime shoqërore	601	4,010,665	4,011
Shpenzime operative	602	6,145,000	6,145
Shpenzime operative (v.gjyqësore)	602	2,700,000	2,700
Transferta (Shoqata e Qarqeve)	602	400,000	400
Transferta(AER)	602	500,000	500
Investime	231	16,361,215	16,361
Shpenzime operative per investimet (projektet)	602	300,000	300
TOTALI i Shpenzimeve nga Granti i pakushtëzuar		55,247,384	55,247
Të ardhurat 2026	Llogaria	Shuma lekë	Shuma lekë
Qendra e të moshuarve	600	1,435,200	1,435
Qendra e të moshuarve	601	277,330	277
Qendra e të moshuarve	602	1,000,000	1,000
Transferta (Shoqata e të verbërve)	602	100,000	100
Taksa Vendore B.Berat	602	100,000	100
Fondi Rezerve	602	587,470	587
Totali i shpenzimeve nga të ardhurat e vitit 2026		3,500,000	3,500
Total buxheti		58,747,384	58,747

2. Shpenzimet do të përdoren sipas pasqyrave bashkëngjitur këtij vendimi.

3. Kryetari i Këshillit të Qarkut autorizohet të bëjë transferimin e fondeve operative pa limit për artikujt e miratuar nga Këshilli i Qarkut.

4. Përgjegjësi i Sektorit të Financës autorizohet të bëjë ndarjen e fondeve të miratuara nga Këshilli i Qarkut sipas strukturës buxhetore të miratuar nga Ministria e Financave për çdo muaj.

5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas miratimit nga Këshilli i Qarkut, në përputhje me nenin 78, pika 3, të Ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar

Këshilltarë gjithsej 18
 Morën pjesë 13
 Votuan Pro 13
 Votuan Kundër -
 Abstenim -

